



ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA
KOSOVA BAR ASSOCIATION

V.KD. NR.22-3/22

KOMISIONI DISIPLINOR I ODËS SË AVOKATËVE TË KOSOVËS, në Kolegjin e përbërë nga Agron Curri - Kryetar, Violeta Jashari dhe Rrahim Ajeti – anëtarë, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Vjollca Ajeti, Administratore në zyrën Disiplinore të OAK-së, në çështjen disiplinore sipas propozimit 91-4/2020 të dt. 29.08.2022, të Prokurorit Disiplinor të OAK-së, kundër avokatit _____ nga _____ me adresë në rr. _____, pa numër, në bazë të nenit 51 paragrafi 1, nënparagrafi, 1.2. të Ligjit për Avokatinë, nr. 04/L-193, lidhur me nenin 123 paragrafi 3 të Statutit të OAK-së dhe nenit 15 dhe 35 të Rregullores për Procedurën Disiplinore për Avokatë dhe Praktikantë, pas mbajtjes së seancës jopublike të shqyrtimit kryesor disiplinor, me dt. 28.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

I paraqituri, avokati _____ nga _____ ne adresë në rr. _____, pa numër, me numër të licencës 1028/2007 të OAK-së.

ËSHTË PËRGJEGJËS

Sepse,

I paraqituri av. _____, me datë 24.12.2020 në cilësinë e avokatit mbrojtës dhe pasi Gjykata kishte shpallur aktgivkimin për të pandehurin _____ në prononcimin e tij për portalin _____ dhe _____ ka deklaruar: "Nëse do isha gjykatës do isha i turpëruar", "nga provat që u kryen gjatë procedurës, e vetmja gjë që u vërtetua me saktësi dhe besueshmëri është se palët e dëmtuara nuk thanë të vërteten, dhe u përcaktua në mënyrë kaq të qartë dhe profesionale sa do të ishte e qartë për fëmijën, e lëre më për një gjykatës profesionist".

Me çka, ka bërë shkelje të rëndë të detyrave dhe autoritetit të avokatisë nga neni 118 paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 të Statutit të OAK-së, lidhur me nenin 37 dhe 38 të Kodit të Etikës Profesionale të Avokatit.

Andaj,

Kolegji Disiplinor i OAK-së, në pajtim me nenin 51 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Avokatinë dhe nenin 123 paragrafi 3 të Statutit të OAK-së, të paraqiturit, avokatit _____ i shqipton masën disiplinore:

GJOBË

- I. Në shumën prej 500.00 € (pesëqind) euro.
- II. Obligohet i paraqituri av. _____, që në emër të paushallit disiplinor të paguaj shumën prej 50.00 € (pesëdhjetë) Euro.
- III. Pagesa gjobës dhe paushallit duhet të bëhen në buxhetin e OAK-së, në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi, nën kërcënimin e përmarimit të detyrueshëm.

Arsyetim

Prokurori Disiplinor i OAK-së, në Komisionin Disiplinor ka paraqitur propozimin disiplinor nr. 91-4/2020 të dt. 29.08.2022, kundër të paraqiturit, av. _____ nga _____, me adresë në rr. _____, pa nr, me nr. të licencës 1028/2007 të OAK-së, me propozimin që të zhvillohet procedura disiplinore për shkelje të rëndë nga neni 118 paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 të Statutit të OAK-së, lidhur me nenin 37 dhe 38 të Kodit të Etikës Profesionale të Avokatit. Propozimi është bërë në bazë të fletëparaqitjes disiplinore me nr. 91/20 e ushtruar nga gjyqtarja znj. _____ Propozimit i është bashkangjitur marrveshja për pranimin e përgjegjësive disiplinore e dt. 17.08.2022.

Kolegji disiplinor, me dt. 07.09.2022, mbajti seancën e shqyrtimit fillestar dhe pasi shqyrtoi propozimin e Prokurorit Disiplinor nr. 91-4/20, dt. 29.08.2022, me provat e bashkëngjitura, konstatoi se ekziston arsyeja bazuar për vazhdimin e procedurës disiplinore ndaj avokatit _____ nga _____

Kolegji Disiplinor, caktoi dhe mbajti seancën kryesore dëgjimore në lidhje me pranimin apo mospranimin e marrveshjes mbi pranimin e përgjegjësive disiplinore me dt. 28.09.2022, në të cilën Prokurori Disiplinor, në pika përmbledhse elaboroi marrveshjen për pranimin e fajësisë të datës 17.08.2022, duke deklaruar se mbetet në tërësi pranë marrveshjes për pranimin e përgjegjësive disiplinore dhe duke i propozuar Kolegjit që të njëjten ta aprovoj. I paraqituri _____, lidhur me marrveshjen për pranimin e përgjegjësive Disiplinore deklaroi se mbetet në tërësi pranë kësaj marrveshje duke i propozuar Kolegjit Disiplinor që e njëjta të aprovohet.

Kolegji Disiplinor gjatë shqyrtimit të pranimin apo mospranimin të marrveshjes për pranimin e përgjegjësive disiplinore, pas dëgjimit të Prokurorit Disiplinor dhe të paraqiturit konform neni 15 të Rregullorës për Procedurën Disiplinore për Avokatë dhe Praktikantë lidhur me nenin 233 të KPPRK-së, konstatoi se janë përmbushur kushtet ligjore, se marrveshja për pranimin e përgjegjësive disiplinore është lidhur në mënyrë vullnetare dhe se e njëjta mbështetet në provat materiale bashkangjitur në shkresat e lëndës. Andaj me AKTVENDIM e pranoi marrveshjen për pranimin e përgjegjësive disiplinore të datës 17.08.2022 sipas propozimit të ZPD nr. 91-4/2020 të dt. 29.08.2022 dhe urdhëroi që e njëjta të jetë pjesë përbërse e shkresave të lëndës.

Kolegji të paraqiturit i shqiptoi masën gjobë të paraparë për këtë shkelje në nenin 51 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Avokatinë dhe nenit 123 paragrafi 3 të Statutit të OAK-së, ashtu siç është rekomanduar me marrveshjen për pranimin e përgjegjësive disiplinore, dhe atë, duke pasur parasysh rrethanat lehtësuese. Kolegji e vlerësoi si rrethanë lehtësuese pranimin e përgjegjësive

si në marrëveshje, të kaluarën disiplinore të të paraqiturit, ku sipas shënimeve të Odës, i njëjti nuk figuron të ketë vendime të formës së prerë për shkelje disiplinore si dhe deklaratimet dhe bashkëpunimin korrekt me Organet Disiplinore të Odes. Kolegji nuk gjeti rrethana rënduese.

Duke pasur parasysh se Kolegji pranoi marrëveshjen për pranimin e përgjegjesisë disiplinore ndaj të paraqiturit vendosi për këtë lloj dhe lartësi të masës, me bindjen se është masë adekuate dhe e mjaftueshme për arritjen e qëllimit të masës disiplinore, e me të cilën synohet ruajtja e nderit, dinjitetit dhe prestigjit të avokatisë.

Lidhur me shpenzimet e procedurës dhe paushallin disiplinor, Kolegji vendosi që i paraqituri të ngarkohet vetëm me paushallin, sepse shpenzime për ekspert, dëshmitarë dhe përkthyes nuk kishte. Vendimin për paushallin, u mor në bazë të nenit 37 paragrafi 1, të Rregullores për Procedurën Disiplinore për Avokatë dhe Praktikantë.

Andaj, nga se u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni Disiplinor i Odës së Avokatëve të Kosovës
V.KD. NR.22-3/22, dt. 28.09.2022

Procesmbajtësja
Ma.sc.Vjollca Ajeti

Kryetar i Kolegjit Disiplinor
Av. Agron Curri

KËSHILLË JURIDIKE

Kundër këtij vendimi, palët kanë të drejtë të paraqesin ankesë në Komisionin e Ankesave të OAK-së, në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të vendimit. Ankesa i dërgohet Komisionit të Ankesave në OAK, përmes këtij Komisioni.